



**MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE
HEKURUDHA SHQIPTARE sh.a**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-KONSULENCË

Datë 13 /10 /2022

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Studim i Fizibilitetit dhe Projekt-Ide për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) : Studimi i fizibilitetit 79314000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 200,224,996 Lekë (dyqind million dyqind njëzet e katër mijë nëntë qind nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Hekurudha Shqiptare Sh.A.” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*
- c. *Deklarata mbi disponueshmërinë e anëtareve të stafit të Konsulentit sipas Shtojcës 7;*
- d. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave energjetike të operatorit ekonomik të regjistruar në Shqipëri.*

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 26, të VKM nr. 285/2021 dhe në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatorët ekonomikë duhet të sigurojnë që të plotësojnë kapacitetet ligjore dhe të kenë aftësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi nëpërmjet paraqitjes së një deklarate për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme, sipas Shtojcës 11.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Xhiro mesatare për tre vitet e fundit (2019, 2020, 2021) jo me e vogël se 40% të shumës së fondit limit.

Për të verifikuar se i plotësojnë këto kushte, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim ose dokumentacion përkatës të lëshuar nga administrata tatimore ose autoriteti përkatës në vendin e origjinës, ku tregohet xhiroja vjetore e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit, 2019, 2020, 2021. Në rastet e sipërmarrjes së përbashkët të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës.

b) Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë kopjet e pasqyrave financiare për vitet 2019, 2020, 2021, të paraqitura dhe të konfirmuara nga organet tatimore përkatëse, në zbatim të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ose legjislacionit në fuqi në vendin e origjinës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në përputhje me vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Kriteret e Përzgjedhjes:

Kriteret e mëposhtme të përzgjedhjes do të zbatohen për ofertuesit. Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh, këto kriteret përzgjedhjeje do të zbatohen për bashkimin e operatorëve në tërësi:

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme:

1. Ofertuesi (*operatori ekonomik ose bashkim operatorësh*) ka zbatuar, gjatë 6 viteve të fundit (*01 Janar 2016 deri në afatin e fundit për pranimin e ofertave të treguar në Njoftimin e Kontratës*), të paktën 1 projekt/kontratë me:
 - vlerë minimale 40% e fondit limit; dhe
 - aktivitete që lidhen me Projektimin Paraprak, Projektimin dhe/ose Studimin e Fizibilitetit të një projekti hekurudhor për përdorim të përzier (trafik mallrash dhe pasagjerësh); dhe
 - prej një gjatësie të paktën 120 km.

Pa rënë në kundërshtim me sa më sipër, projektet/kontratat e sjella si referencë nga OE mund të jenë realizuar si përvojë ku pjesëmarrja të ketë qenë si OE ose si BO me pjesëmarrje minimale prej 50%.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Kjo dispozitë autorizon Autoritetet Kontraktore të vendosin vetë kriteret në bazë të një diskrecioni të ligjshëm që plotëson kushtet dhe kriteret e kësaj dispozite. Ky diskrecion nuk mundet që të kufizohet nga ndonjë normë tjetër nënligjore e lëshuar pa këte autorizim specifik. Për më tepër, neni 41, pika 3 i VKM nr. 285/2021 nuk ndalon këtë kohështirje qoftë në testin e proporcionalitetit apo edhe te vetë përmbajtjes së RRPP (punë publike/ shërbim/ mallra, etj).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare për shërbimet e konsulencës. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues ka përvojën e nevojshme rajonale/ndërkombëtare në projekte në përmasa dhe kompleksitet të ngjashëm në fushën e transportit hekurudhor.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të Operatorëve Ekonomikë, Autoriteti Kontraktor i referohet projekteve të 6 viteve të fundit (nga 01 Janar 2016) duke marrë si bazë hyrjen në fuqi në 2016 të TSI “Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit”, një specifikim teknik për ndërveprueshmërinë e sistemit hekurudhor evropian, i parashikuar në Direktivën Evropiane 2016/797 të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. “TSI - Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit” është baza mbi të cilën është ndërtuar ky shërbim konsulence dhe, rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktor gjykon të vlefshme përvojën teknike të Ofertuesve gjatë periudhës efektive të “TSI - Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit”.

Gjithashtu është marrë në konsideratë periudha e lockdown të industrisë së shërbimeve për shkak të pandemisë Covid 19 dhe shtrirjen në kohë të projekteve të kësaj natyre. Studimi i Fizibilitetit dhe Projekt-Ideja për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë është një investim ndërkombëtar që përfshin Shqipërinë dhe Kosovën dhe do të zbatohet në territorin e këtyre dy shteteve. Si një projekt ndërkombëtar, ai duhet të plotësojë kërkesat dhe standardet ndërkombëtare, pa u limituar në kriteret, apo standardet specifike të njërit shtet, apo tjetrit. Referenca në “Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit”, i parashikuar në Direktivën Evropiane 2016/797 të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian është i domosdoshëm, pasi shmang mospëputhjet eventuale ndërmjet kriterëve dhe standardeve të projektimit të hekurudhuave në dy shtetet përfitues të investimit, si dhe bën të mundur aplikimin e një standardi evropian, bashkëkohor dhe të unifikuar.

Vecoria e këtij shërbimi dikton edhe në përcaktimin e këtij kriteri pasi nuk bëhet fjalë për një shërbim konsulence të një natyre të zakonshme, lehtësisht të gjendshme në domainin publik dhe atë privat, por për një shërbim që lidhet nga politika qeverisëse strategjike. E thënë ndryshe, kjo është një fushë që ndikohet nga strategjitë qeverisëse të një apo disa vendeve në zhvillimin e kësaj infrastrukture.

Kërkesa për vlerën minimale prej 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet është

vendosur në përputhje me nenin 41/3 të RRPP-së, e cila lejon AK të kërkojnë si dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme të ngjashme.

Për t'u bindur se OE zotëron përvojën e mëparshme, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie nga autoriteti/enti kontraktor është kërkuar dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme.

Në këtë kontekst, Autoriteti Kontraktor përcakton gjatësinë prej 120 km në proporcion me gjatësinë e lidhjes hekurudhore nga Durrësi në Prishtinë (300 km), për të cilën Operatori Ekonomik do të kryejë një studim të plotë duke llogaritur analizën ekonomiko/financiare, analizën e kërkesës dhe të trafikut, etj, si kriter teknik kualifikues.

Vlen të theksohet se shërbimi në fjalë parashikon Studimin e Fizibilitetit të një projekti hekurudhor për përdorim të përzier (trafik mallrash dhe pasagjerësh) prej një gjatësie rreth 300 km, të shtrirë në dy shtete. Me punë të ngjashme është kuptuar realizimi i Projektimit Paraprak, Projektimit dhe/ose Studimin e Fizibilitetit të një projekti hekurudhor për përdorim të përzier (trafik mallrash dhe pasagjerësh), sikurse projekti objekt kontrate, ndërsa për të mos rënduar OE dhe për të rritur konkurrencën, duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe përmasat e këtij projekti është kërkuar përvojë në realizimin e shërbimeve të kësaj natyre, në të paktën 40% të përmasave të tij e përkthyer në një gjatësi të paktën 120 km.

Gjithashtu, kërkesa që OE të ketë të paktën 50% të pjesëmarrjes në projektet në të cilët ka marrë pjese si Bashkimi Operatorësh, e sjellë si referencë, do të demonstrojë besueshmerinë në këtë përvojë, duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe përmasat e këtij projekti. Edhe në referencë të frymës së ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht të nenit 77, pika 4, autoritetet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Ofertuesi (operatori ekonomik ose bashkim operatorësh) ka zbatuar, gjatë 6 viteve të fundit (01 Janar 2016 deri në afatin e fundit për pranimin e ofertave të treguar në Njoftimin e Kontratës), të paktën 1 projekt/kontratë me

aktivitete që lidhen me një minimum prej 20 km tunele dhe 40 km struktura (ura, murë mbajtëse, tombino, etj); dhe

si pjesë e një Projektimi Paraprak, Projektimi dhe/ose Studimi i Fizibilitetit të një projekti hekurudhor.

Pa rënë në kundërshtim me sa më sipër, projektet/kontratat e sjella si referencë nga OE mund të jenë realizuar si përvojë ku pjesëmarrja të ketë qenë si OE ose si BO me pjesëmarrje minimale prej 50%.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Kjo dispozitë autorizon Autoritetet Kontraktore të vendosin vetë kriteret në bazë të një diskrecioni të ligjshëm që plotëson kushtet dhe kriteret e kësaj dispozite. Ky diskrecion nuk mundet që të kufizohet nga ndonjë normë tjetër nënligjore e lëshuar pa këte autorizim specifik. Për më tepër, neni 41, pika 3 i VKM nr. 285/2021 nuk ndalon këtë kohështirje qoftë në testin e proporcionalitetit apo edhe te vetë përmbajtjes së RRPP (punë publike/ shërbim/ mallra, etj).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare për shërbimet e konsulencës. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues ka përvojën e nevojshme rajonale/ndërkombëtare në projekte në përmasa dhe kompleksitet të ngjashëm në fushën e transportit hekurudhor.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të Operatorëve Ekonomikë, Autoriteti Kontraktor i referohet projekteve të 6 viteve të fundit (nga 01 Janar 2016) duke marrë si bazë hyrjen në fuqi në 2016 të TSI “Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit”, një specifikim teknik për ndërveprueshmërinë e sistemit hekurudhor evropian, i parashikuar në Direktivën Evropiane 2016/797 të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. “TSI - Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit” është baza mbi të cilën është ndërtuar ky shërbim konsulence dhe, rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktor gjykon të vlefshme përvojën teknike të Ofertuesve gjatë periudhës efektive të “TSI - Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit”.

Gjithashtu është marrë në konsideratë periudha e lockdown të industrisë së shërbimeve për shkak të pandemisë Covid 19 dhe shtrirjen në kohë të projekteve të kësaj natyre. Studimi i Fizibilitetit dhe Projekt-Ideja për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë është një investim ndërkombëtar që përfshin Shqipërinë dhe Kosovën dhe do të zbatohet në territorin e këtyre dy shteteve. Si një projekt ndërkombëtar, ai duhet të plotësojë kërkesat dhe standardet ndërkombëtare, pa u limituar në kriteret, apo standardet specifike të njërit shtet, apo tjetrit. Referenca në “Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit”, i parashikuar në Direktivën Evropiane 2016/797 të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian është i domosdoshëm, pasi shmang mospëpëthjet eventuale ndërmjet kriterëve dhe standardeve të projektimit të hekurudhuave në dy shtetet përfitues të investimit, si dhe bën të mundur aplikimin e një standardi evropian, bashkëkohor dhe të unifikuar.

Vecoria e këtij shërbimi dikton edhe në përcaktimin e këtij kriteri pasi nuk bëhet fjalë për një shërbim konsulence të një natyre të zakonshme, lehtësisht të gjendshme në domainin publik dhe atë privat, por për një shërbim që lidhet nga politika qeverisëse strategjike. E thënë ndryshe, kjo është një fushë që ndikohet nga strategjitë qeverisëse të një apo disa vendeve në zhvillimin e kësaj infrastrukture.

Kërkesa për vlerën minimale prej 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet është vendosur në përputhje me nenin 41/3 të RRPP-së, e cila lejon AK të kërkojnë si dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme të ngjashme.

Për t’u bindur se OE zotëron përvojën e mëparshme, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie

nga autoriteti/enti kontraktor është kërkuar dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme.

Referuar VKM nr.35, 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje, dhe kolaudim" dhe konkretisht nenit 44/2/4, i cili përcakton shkallën e vështirësisë së zonave funksionale dhe/ose kërkesat konstruktive dhe teknike në varësi të gjatësisë së rrugës hekurudhore, e cila parashikohet të shtrihet në pjesën më të madhe të gjatësisë së saj në tunele dhe vepra arti (ura, murë mbajtëse, tombino, nënkalime/mbikalime, etj), ndërsa për të mos rënduar OE dhe për të rritur konkurrencën, duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe përmasat e këtij projekti është kërkuar përvojë në realizimin e shërbimeve të kësaj natyre, në të paktën 40% të përmasave të tij e përkthyer në një gjatësi të paktën prej 20 km tunele dhe 40 km vepra arti, e përcaktuar si 40% e gjatësisë totale të linjës së re hekurudhore që do të ndërtohet, e cila do të lidhë segmentin Vorë – Han i Hotit me Prizren – Klinë (~150 km). Këto qasje teknike, mbi të cilën janë vendosur keto kritere, janë parashikuar dhe elaboruar dhe në projektet infrastrukturore për rehabilitimin e linjave hekurudhore në kuadër të Projekteve të Instrumentit të Investimeve të Ballkanit Perendimor, WBIF, të realizuar nga Konsulentet e Huaj.

Vlen të theksohet se kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, duke iu referuar standardeve ndërkombetare për shërbimet e konsulencës. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se Operatori Ekonomik fitues ka përvojën e nevojshme në projekte në përmasa dhe kompleksitet të ngjashëm në fushën e transportit hekurudhor dhe i referohet terrenit të vështirë dhe të thepisur me një pjerrtësi të konsiderueshme ku do të kalojë linja hekurudhore.

Gjithashtu, kërkesa që OE të ketë të paktën 50% të pjesëmarrjes në projektet në të cilët ka marrë pjesë si Bashkimi Operatorësh, e sjellë si referencë, do të demonstrojë besueshmerinë në këtë përvojë, duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe përmasat e këtij projekti. Edhe në referencë të frymës së ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht të nenit 77, pika 4, autoritetet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

2. Ofertuesi (*shoqëri individuale ose bashkim operatorësh*) ka zbatuar, gjatë 6 viteve të fundit (*01 Janar 2016 deri në afatin e fundit për pranimin e ofertave të treguar në Njoftimin e Kontratës*), të paktën 1 projekt/kontratë me:

- aktivitete të lidhura me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), Analizë mbi Projektionet e Trafikut, dhe Analiza Financiare/Ekonomike për një projekt të transportit linear.

Pa rënë në kundërshtim me sa më sipër, projektet/kontratat e sjella si referencë nga OE mund të jenë realizuar si përvojë ku pjesëmarrja të ketë qenë si OE ose si BO me pjesëmarrje minimale prej 50%.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Kjo dispozitë autorizon Autoritetet Kontraktore të vendosin vetë kriteret në bazë të një diskrecioni të ligjshëm që plotëson kushtet dhe kriteret e kësaj dispozite. Ky diskrecion nuk mundet që të kufizohet nga ndonjë normë tjetër nënligjore e lëshuar pa këte autorizim specifik. Për më tepër, neni 41, pika 3 i VKM nr. 285/2021 nuk ndalon këtë kohështrirje qoftë në testin e proporcionalitetit apo edhe te vetë përmbajtjes së RRPP (punë publike/ shërbim/ mallra, etj).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare për shërbimet e konsulencës. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues ka përvojën e nevojshme rajonale/ndërkombëtare në projekte në përmasa dhe kompleksitet të ngjashëm në fushën e transportit hekurudhor.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të Operatorëve Ekonomikë, Autoriteti Kontraktor i referohet projekteve të 6 viteve të fundit (nga 01 Janar 2016) duke marrë si bazë hyrjen në fuqi në 2016 të TSI “Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit”, një specifikim teknik për ndërveprueshmërinë e sistemit hekurudhor evropian, i parashikuar në Direktivën Evropiane 2016/797 të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. “TSI - Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit” është baza mbi të cilën është ndërtuar ky shërbim konsulence dhe, rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktor gjykon të vlefshme përvojën teknike të Ofertuesve gjatë periudhës efektive të “TSI - Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit”.

Gjithashtu është marrë në konsideratë periudha e lockdown të industrisë së shërbimeve për shkak të pandemisë Covid 19 dhe shtrirjen në kohë të projekteve të kësaj natyre. Studimi i Fizibilitetit dhe Projekt-Ideja për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë është një investim ndërkombëtar që përfshin Shqipërinë dhe Kosovën dhe do të zbatohet në territorin e këtyre dy shteteve. Si një projekt ndërkombëtar, ai duhet të plotësojë kërkesat dhe standardet ndërkombëtare, pa u limituar në kriteret, apo standardet specifike të njërit shtet, apo tjetrit. Referenca në “Specifikimet Teknike të Interoperabilitetit”, i parashikuar në Direktivën Evropiane 2016/797 të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian është i domosdoshëm, pasi shmang mospëputhjet eventuale ndërmjet kriterëve dhe standardeve të projektimit të hekurudhuave në dy shtetet përfitues të investimit, si dhe bën të mundur aplikimin e një standardi evropian, bashkëkohor dhe të unifikuar.

Vecoria e këtij shërbimi dikton edhe në përcaktimin e këtij kriteri pasi nuk bëhet fjalë për një shërbim konsulence të një natyre të zakonshme, lehtësisht të gjendshme në domainin publik dhe atë privat, por për një shërbim që lidhet nga politika qeverisëse strategjike. E thënë ndryshe, kjo është një fushë që ndikohet nga strategjitë qeverisëse të një apo disa vendeve në zhvillimin e kësaj infrastrukture.

Referuar Ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, shtojca 1, pika 7.a, tipologjia e projektimit për ndërtimin e linjave për trafik hekurudhor me distanca të gjata përfshihet në veprimtaritë me ndikim në mjedis.

Për t'u bindur se OE zotëron përvojën e mëparshme, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie nga autoriteti/enti kontraktor është kërkuar dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme.

Në këtë kontekst, Autoriteti Kontraktor gjykon se Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM), Analiza mbi Projektionet e Trafikut, dhe Analiza Financiare/Ekonomike, si aktivitete që janë parashikuar për tu zhvilluar nga Konsulenti bazuar në Termat e Referencës, janë elementë të një peshe të rëndësishme dhe të cilat gjykojnë thelbësore për mbarëvajtjen e studimit. Kjo kërkesë vendoset që AK të garantohet për besueshmërinë dhe reputacionin e OE, i cili duhet të ketë të konsoliduara aftësitë e tij në disiplina të ndryshme që ndikojnë në zbatimin e këtij studimi.

Gjithashtu, kërkesa që OE të ketë të paktën 50% të pjesëmarrjes në projektet në të cilët ka marrë pjesë si Bashkimi Operatorësh, e sjellë si referencë, do të demonstrojë besueshmërinë në këtë përvojë, duke marrë në konsideratë kompleksitetin dhe përmasat e këtij projekti. Edhe në referencë të frymës së ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht të nenit 77, pika 4, autoritetet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

2.3.2. Staf

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se zotëron pjesë të stafit të tij “*key experts/ekspertët kryesorë*” për realizimin e këtij shërbimi si mëposhte. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë: listën e kryesore të ekspertëve kryesor, kontratën e punës ose marrëveshjen e angazhimit për këtë procedurë të prokurimit, CV-të dhe diplomatat universitare përkatëse si pjesë e ofertës teknike.

- I. Një **Drejtues Ekipi/Team leader** (*inxhinier ndërtimi*) që mban një diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi, me një përvojë prej minimumi 15 vitesh në një rol të lartë drejtues në projekte/studime në projekte të infrastrukturës së transportit, duke menaxhuar të paktën dy studime fizibiliteti dhe/ose projekte në përmasa dhe kompleksitet të ngjashëm në fushën e transportit hekurudhor.
- II. Një **Inxhinier Projektues Hekurudhash** me diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi, me një përvojë prej minimumi 10 vitesh përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës hekurudhore. Eksperiencë në projektimin e hekurudhave në kuadrin e të paktën 2 studimeve të përmasave dhe kompleksitetit të ngjashëm për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e shinave hekurudhore.
- III. Një **Inxhinier Projektues Konstruktore për Tunele, Ura dhe Vepra Arti** me një diplomë universitare në Inxhinieri Ndërtimi, me një minimum prej 10 vitesh përvojë në një rol të lartë në projekte/studime në fushën e infrastrukturës së transportit, duke menaxhuar të paktën dy 2 studime në përmasa dhe kompleksitet të ngjashëm në fushën e infrastrukturës së transportit.
- IV. Një **Inxhinier Projektues i Sinjalizimit Hekurudhor** me një diplomë universitare në Inxhinieri Elektrike/Elektronike/Mekanike, me një përvojë rajonale/ndërkombëtare minimumi 10 vjetore në projektimin/ndërtimin e sinjalizimit hekurudhor, duke menaxhuar të paktën 2

projekte projektimi/fizibiliteti për sinjalizimin me ndërlidhje elektronike në projekte të infrastrukturës hekurudhore

- V. Një **Ekonomist** me eksperiencë në fushën e Transportit me diplomë universitare në Ekonomi/Financë, me një përvojë rajonale/ndërkombëtare prej minimumi 15 vitesh në projekte/studime të infrastrukturës së transportit, dhe të ketë menaxhuar të paktën dy analiza ekonomike (kosto-përfitim) në kuadër të studimeve të fizibilitetit në fushën e infrastrukturës së transportit.
- VI. Një **Inxhinier Mjedisi** me diplomë universitare në Inxhinieri Mjedisi, me të paktën 10 vjet përvojë në zhvillimin e studimeve të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) për projektet lineare të infrastrukturës, dhe të ketë menaxhuar të paktën dy VNM në kuadër të studimeve parafizibilitet/fizibilitet/projektim për të paktën dy projekte lineare të infrastrukturës.

. (Ky kriter përmbushet nepermjet plotesimit te formularit te vetdeklarimit sipas shtojces 12 . Operatori ekonomik i klasifikuar i pari duhet te paraqese dokumentacionin e kerkuar ne nenin 26 te V.K.M 285 19.05.2021 i ndryshuar perpara publiimit te njoftimit te fituesit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 41, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon një listë të personelit kryesor (key experts), të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për stafin kryesor të konsulences është bere ne perputhje me natyren e studimit të fizibilitetit dhe me kërkesat specifike për zbatimin me sukses të kesaj kontrate nga Operatori Ekonomik.

Përzgjedhja e stafit kryesor të Operatorit Ekonomik është përcaktuar në përputhshmëri të plotë me specifikimet e paraqitura në VKM nr. Nr. 514, datë 20.9.2017 ”Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)” si më poshtë vijon:

- Drejtues Ekipi (*inxhinier ndërtimi*) – 2142.31: Inxhinier infrastrukture dhe transporti
- Inxhinier Projektues Hekurudhash – 2142.33 – Projektues për hekurudha
- Inxhinier Projektues për Tunele, Ura dhe Vepra Arti – 2142.34 - Projektues për vepra arti
- Inxhinier Projektues i Sinjalizimit Hekurudhor – 2164.06 – Planifikues i sinjalizimit rrugor/hekurudhor
- Ekonomist për Fushën e Transportit - 2631.13 - Ekonomist
- Inxhinier Mjedisi – 2143.03 - Inxhinier mjedisi

Kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me eksperiencën e ekspertëve të Operatorit Ekonomik janë bazuar në VKM nr. 943, datë 28.12.2016, konkretisht në nenin 22 dhe lidhjen nr.2, duke iu referuar kushteve për studim e projektim që të disponojnë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshijë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilet përkatëse, të lëshuar nga institucionet e arsimit

të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë certifikatat e mëposhtme:

- a) Operatori ekonomik paraqet Certifikatën **ISO 14001: 2015** “Për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor” (*e vlefshme*) ose një ekuivalente në përputhje me objektin e kontratës. Në rastin e sipërmarrjes së përbashkët të operatorëve ekonomikë, të paktën vetëm një anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e sipërpërmendur.
- b) Operatori ekonomik do të paraqesë Certifikatën **ISO EN 9001: 2015** për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” (*e vlefshme*) ose një ekuivalente në përputhje me objektin e kontratës. Në rastin e sipërmarrjes së përbashkët të operatorëve ekonomikë, të paktën një anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e sipërpërmendur.

Këto certifikata lëshohen nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organi kombëtar i akreditimit ose organizmat ndërkombëtarë të akreditimit, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

AK, bazuar në dispozitat më sipër cituar konsideron të nevojshme paraqitjen e dokumentacionit (certifikatat) dëshmuar të pajtueshmërisë së ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. Certifikatat e kërkuara nga AK lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe specifikën e produkteve të kërkuara.

Në vijim shtjellohen certifikatat ISO dhe jo vetëm të kërkuara nga AK.

Kriteri 2.3.3.a është kriter për paraqitjen pranë AK të dokumentacionit vërtetues mbi kapacitetet që ka subjekti për ofrimin e një produkti cilësor, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit Mjedisor.

Kjo nënkupton se Kontraktori duhet të ketë kaluar nëpër një proces auditimi për për hartimin dhe zbatimin e një sistemi të menaxhimit mjedisor dhe të ketë marrë certifikatë që vërteton se standardet e menaxhimit mjedisor me të cilat operon kjo kompani, apo organizatë, përputhen me standardet ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor. Standardi ndërkombëtar ISO specifikon sistemet e menaxhimit mjedisor, në mënyrë që kompania, apo organizata të mund të kënaqë pritshmëritë e klientit (i cili në këtë rast është Hekurudha Shqiptare) duke i ofruar këtij të fundit shërbime ose produkte cilësore. Në këtë mënyrë, kompania, apo organizata do të duhej të dëshmonte kapacitetin për të ofruar një produkt dhe shërbim cilësor, në përputhje me standardet ndërkombëtare, me anë të paraqitjes së një certifikate që dëshmon përputhmërinë e standardeve me të cilat ajo operon me ato standarde ISO që shtjellojnë mënyrat, kërkesat dhe kriteret për menaxhimin mjedisor.

Kriteri 2.3.3.b është kriter për paraqitjen pranë AK të dokumentacionit vërtetues mbi kapacitetet që ka subjekti për ofrimin e një produkti cilësor, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Cilësisë.

Kjo nënkupton se Kontraktori duhet të ketë kaluar nëpër një proces auditimi të cilësisë, përmirësimi të saj dhe të ketë marrë certifikatë që vërteton se standardet e cilësisë me të cilat operon kjo kompani, apo organizatë, përputhen me standardet ndërkombëtare të cilësisë. Standardi ndërkombëtar ISO specifikon sistemet e menaxhimit të cilësisë, në mënyrë që kompania, apo organizata të mund të kënaqë pritshmëritë e klientit (i cili në këtë rast është Hekurudha Shqiptare) duke i ofruar këtij të fundit shërbime ose produkte cilësore. Në këtë mënyrë, kompania, apo organizata do të duhej të dëshmonte kapacitetin për të ofruar një produkt dhe shërbim cilësor, në përputhje me standardet ndërkombëtare, me anë të paraqitjes së një certifikate që dëshmon përputhmërinë e standardeve me të cilat ajo operon me ato standarde ISO që shtjellojnë mënyrat, kërkesat dhe kriteret për menaxhimin e cilësisë.

Një kompani, apo organizatë e certifikuar sipas ISO 9001 ka implementuar kërkesat për Sistem Cilësor Menaxhimi në të gjitha fushat e biznesit.

Zotërimi i një certifikate ISO 9001 nga ana e kompanisë, apo organizatës është një garanci për klientin, se kompania, apo organizata, ka asetet e nevojshme, për të ofruar një shërbim apo produkt cilësor në fushën që operon.

ISO 9001:2015 specifikon kërkesat kundrejt një menaxhimi cilësor të cilësisë kur një subjekt (organizatë):

- a) Duhet të dëshmojë aftësinë që në mënyrë të vazhduar të nxjerrë produkte dhe shërbime që plotësojnë edhe kërkesat e zbatueshme ligjore edhe ato rregullative të klientit, si dhe*
- b) synon të rrisë kënaqësinë e klientit përmes zbatimit efektiv të sistemit, përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e klientit dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative.*